

I

Rruga “Çerbëri”

Kujtimet e mia të para lidhen me zgjimin nga zhurma e mbytur që bënte përplasja e mamit pas murit të dhomës ngjitur dhe zëri i babait të nxehur keq, që i bërtiste. Ndërsa dëgjoja goditjet, rënkimet, ulërimat, vetëm pak hapa larg, shtrihesha e heshtur dhe e tmerruar në shtratin tim, duke u mbledhur kruspull nën mbulesat e tërhequra deri lart për të mos dëgjuar asgjë.

Nëpërmjet murit të hollë, dëgjoja babanë tek i vërsulej nënës me një lumë të sharash: “Ti lopë kurvë, ti pelë koti, mendon se mund të më thuash «jo», ë? Jam burri yt dhe kam të drejtat e mia! Tani shtrihu në shtrat dhe më jep atë që dua, ose do të hash edhe ca të tjera si këto.” Një e goditur tjetër, që pasohej nga një britmë dhe rënkime të dhimbshme të mamit. Një çast më vonë ngrihej zëri i saj i hollë: “Bastard, ti je bastard i ndyrë!” Një tjetër e goditur, një tjetër britmë. “Si the? Kam dy prindër unë, moj lopë debile!”

Pranë meje, vëllai im Lorenci, pesëvjeç, një vit më i madh se unë, qëndronte më gjunjë, me shpatullat e vogla që i dridheshin, me fytyrën e ngjeshur pas jastëkut për të mbytur zërat e tmerrshëm. Në mes të dhomës, Kimi, motra jonë e vogël, ende foshnjë, qante në shtratin e saj. Ajo ishte shumë e vogël për t’i kuptuar ato që dëgjonte, por mjaft e madhe sa për të marrë vesh se ishte diçka e frikshme dhe e keqe.

Kjo skenë përsëritej çdo mëngjes. Ishte mënyra si e fillonim ditën, dhe për ne ishte normale. Por kjo nuk e bënte më të lehtë. Ndijshe një lëmsh në stomak dhe lutesha e lutesha me pëllëmbët e djersitura, të ngjitura fort pas njëra-tjetrës nën mbulesa, që të merrnin fund të bërtiturat dhe goditjet. Ndonjëherë Lorenci nuk duronte më, por vraponte në dhomën e prindërve duke bërtitur: “Mjaft! Mjaft!

Lëre rehat! Lëshoje!”, dhe hidhej mbi babanë në një përpjekje të dëshpëruar për të mbrojtur mamin. Babai e përzinte me fishkëllima: “Ik pirdhu, ti trap i vogël!”, e rrëmbente vëllanë me një dorë dhe e vërviste jashtë dhomës. Lorenci përplasej në dysheme dhe zvarritej deri në dhomë, i vrarë keq e duke dënesur nga dhembja dhe frika.

Tingujt që dëgjonim më pas përmes mureve të dhomës ishin mërmërimat dhe gulçimet e prindërve tek bënin seks. Sigurisht, në atë moshë nuk e dinim saktësisht ç’do të thoshin ato zhurma. Dinim se ishte diçka që babai i bënte mami dhe që mami nuk e donte, dinim edhe se, kur bënin ashtu, kishte shumë gulçime dhe mërmërima. Dhe dinim gjithashtu se duhej të ishte diçka e tmerrshme, por të paktën pas kësaj babai nuk e qëllonte më mamin.

Sapo mbaronin, mami dilte nga dhoma duke lidhur fustanin e saj të vjetër e të ngjitur pas trupit të hollë e duke mbajtur syzet e thyera. Shkonte në kuzhinë e i gjente punë vetes duke mbushur çajnikun, që e vendoste më pas mbi një furnelë të vogël për të bërë çajin. Ne rrinim sy e veshë derisa ta dëgjonim t’i çonte babait mëngjesin. Kur ajo kthehej në kuzhinë, e ndiqnim të tre nga pas. Mami ulej në karrigen e vjetër prej druri pranë tavolinës së vogël. Poshtë fustanit i dukeshin blanat mavi dhe të çarat në trup, ndërsa shpesh kishte gjak në cep të buzës ose i rridhte nga ndonjë e çarë në fytyrë. Ajo përpiqej të ngjiste syzet e thyera me leukoplast, ndërsa lotët i rridhnin çurg dhe trupi i dridhej aq shumë, sa nuk arrinte t’i vinte dot syzet. Ne ngriheshim, i shkonim pranë, e preknim tërë ankth nga krahët dhe i thoshim: “Mos qaj, mami”. Ajo vështronte nga dera se mos na shihte babai dhe pastaj na kapte nga duart e na thoshte të shkonim të visheshim duke na pëshpëritur: “Do të bënit mirë të dilnit jashtë përpara se të ngrihet babai.”

Mblidhnim rrobat nga dyshemeja, ku i kishin hedhur një natë më parë. Binim në shtrat me kanotierë e mbathje; ndodhte që ato nuk i hiqnim edhe për javë të tëra,

ndërsa rrobat e tjera thjesht i vishnim sipër tyre. Ishim shumë të vegjël për t'u veshur vetë siç duhej, kështu që çdo gjë e vishnim së prapthi apo me pullat e mbërthyera keq. Unë dhe Lorenci e vishnim Kimin si mundnim përpara se të ktheheshim në kuzhinë, duke shpresuar të hanim mëngjes.

Ashtu si pjesa tjetër e shtëpisë, kuzhina ishte e papastër dhe mbante erë të keqe. Në një tabaka të dëmtuar nga përdorimi, mbi syprinën prej qeramike të tavolinës qëndronte një ibrik ngjyrëkafe, edhe ai i dëmtuar, dhe disa kupa të ciflosura. Përveç një pakoje çaji, një vazo me sheqer dhe një shishe qumësht të mbushur përgjysmë, dollapi ynë i ushqimeve zakonisht ishte bosh. Qumështi gjatë natës krijonte një cipë të hollë dhe fillonte të prishej. Edhe vazoja e sheqerit ishte shpesh bosh, prandaj mami i hidhte pak ujë të ngrohtë për të shkrirë atë që kishte ngrirë në fund. I vetmi ushqim që gjenim ishin ca kore të thata buke, por pjesa më e madhe e tyre ruheshin për mëngjesin e babait. Mami i fuste koret në një tas, u hidhte sheqer me bollëk dhe më pas qumësht të nxehtë. Kjo i shërbehej në shtrat së bashku me filxhanin e zakonshëm të çajit dhe cigaret. Për ne fëmijët mëngjesi zakonisht ishte një filxhan çaj me qumësht të holluar me ujë për ta shtuar, kështu që për t'i dhënë shije i hidhnim sheqer, gjithmonë po të kishte mbetur. Po të kishim fat, mund të gjenim koren e fortë të panines së një dite më parë, që e ndanim me njëri-tjetrin.

Pas mëngjesit mami na nxirrte jashtë, ku duhej t'ia dilnim mbanë vetë, dhe na thoshte të mos ktheheshim derisa të vinte koha e çajit. E dinim se babai do të ulej në kolltuk në dhomën e ndenjjes për gjithë pjesën tjetër të ditës, përpara televizorit duke pirë cigare e filxhanë çaji pa fund. Po t'ia prishnim terezinë, i hapnim bela vetes. Kështu që uleshim buzë trotuarit si një radhë e vogël birilash, me fytyrat e palara, rrobat e lerosura dhe këpucët që i hiqnim zvarrë, duke pritur fëmijët e tjerë të dilnin jashtë.

Ishin vitet 1960 dhe bumi i ndërtimeve të pasluftës nuk e kishte arritur ende skajin tonë në Londër. Ne jetonim në një zonë në periferinë lindore, Ist-End, që me sa dukej ishte lënë në harresë dhe ishte prishur nga koha. Rruga “Çerbëri” në Borof të Çorediçit (që më vonë mori emrin “Haknei”), e zhveshur dhe e shëmtuar, ishte një nga rrugët e shumta të ngjashme, që shkojnë paralel me njëra-tjetrën. Në të dyja anët rreshtoheshin shtëpi të stilit viktorian gjysmë të rrënuara, të gjitha me familje të mëdha, që jetonin në kushte johigjienike. Nuk kishte as pemë e as shkurre për të zbutur sadopak pisllekun e madh, e as makina të parkuara në rrugë, sepse asnjë nuk mund ta përballonte një të tillë.

Ne ndanim së bashku me tri familje të tjera një nga ato shtëpitë e mëdha të shëmtuara. Ashtu si banesat e tjera të rrugës, ajo duhej shkatërruar vite më parë - dhe në të vërtetë më pas u shkatërrua, kur i gjithë rreshti i shtëpive u shemb dhe në vend të tyre u ngritën apartamente të reja. Kur jetonim në “Çerbëri”, i gjithë vendi mbante erë nga pislleku dhe shkatërrimi, në hyrje dhe nëpër shkallë kishte plehra gjithandej. Apartamenti ynë ishte në katin përdhes, ku të pesë jetonim në dy dhoma e një kuzhinë të vockël, me banjën jashtë, në oborrin e pasmë. Nga dritaret e mëdha e të mbyllura drita mezi depërtonte dhe e gjithë shtëpia ishte me lagështirë, e errët dhe e pistë. Ne fëmijët flinim në dhomën e ndenjes. Lorenci dhe unë në një shtrat të sajuar, që e palosnim gjatë ditës, ndërsa Kimi në një shtrat fëmijësh në cep të dhomës. Dyshekët tanë të vjetër kishin lëshuar bark, ndërsa çarçafët, këllëfët dhe batanijet ishin të holla, tërë njolla, të vjetra, që as të mbanin ngrohtë, as ndiheshin rehat. Mobiliet ishin një mishmash rraresh të hedhura nga të tjerët. Nuk kishim perde, asgjë nuk përshtatej e të kombinonte, ndërkohë që edhe ata pak sirtarë ishin bosh, pasi të gjithë ne kishim pak sende apo rroba dhe askush nuk e çante kokën t’i lante e t’i vinte nëpër vende.

Kur dilnim jashtë, nuk kishim ku të luanim përveç zonave të bombarduara, ende të pandërtuara, që na rrethonin. Aty ishte rreptësisht e

ndaluar të shkoje, por, si të gjithë fëmijët e tjerë të rrugës, e kalonim pjesën më të madhe të kohës duke luajtur mes pirgjeve të rrënojave, tullave dhe xhamave të thyer. Por fëmijët e tjerë nuk na donin. Edhe në kushtet e një mjerimi të tillë kishte një lloj radhe dhe ne e dinim se vendi ynë ishte në fund. E ndienim veten të mënjanuar që në çastin që dilnim në rrugë. Pesë minuta përpara se të dilnim, prindërit do të kishin bërë ndonjë skenë nga ato të zakonshmet. Mami fillonte të fliste me gruan që e kishte derën ngjitur me tonën, ndërsa babai, i tërbuar nga zemërimi që ajo rrinte kot në vend që t'i bënte çajin, dilte jashtë dhe fillonte ta rrihte e ta gjuante me shkelma. Ai e tërhiqte zvarrë brenda duke e sharë e duke e goditur, pastaj, duke u zgërdhirë, u thoshte fqinjëve, që shikonin gojëhapur, se ajo ishte një grua që duhej marrë me shpulla. Brenda pak javësh të gjithë e dinin se Ronald Pontingu e rrihte të shoqen, Lilianën, pothuaj përditë. Hapej fjala se në katin tonë kishte plasur sherri dhe kalamajtë mblidheshin jashtë duke qeshur e duke sharë me zë të lartë.